

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandí?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/john-goci-konkurren-donald-trump-sa-do-te-shkoje-a-nkandi-i585558
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 09:12:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 09:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e01c52bd08dfb6598bc5d5608e2e87358fdb943ef4121b1ec55b5315557bdda0
TEKSTI	28b4aa652796344bdf6b47cd811cf51159da392a895bd40104dafa78e54efac
PAMJA	d5668b808b45b84e770099c65f0d8929563fd7b6f0600f359876af428690f931

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2b170baf238a00c6d8b8202e4b7f116715cd994db5a1e784cd70b47a81a24f4
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/a2b170baf238a00c6d8b8202e4b7f116715cd994db5a1e784cd70b47a81a24f4>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e [Beteja e fundit për ish-krerët e UÇK! Rama: Liri për çlirimtarët, I haçi do të triumfojë me forcen e se vertetësMauzoleumi i zbuluar në Bulqizë, finalist për Çmimin Nderkombëtar “Palmyra”Putur fundit](#)

John Goci konkurron Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

12 Shtator 2026, 11:40Blog Thoma Gëllçi



Ka disa gjëra në jetë që njeriu nuk duhet t'i refuzojë: një kafe, kur ta ofrojnë. Një darkë, kur e paguan tjetri. Dhe pesë mijë dollarë, kur t'i premtan Presidenti i Shteteve të Bashkuara.

Donald Trump, në konventën republikane në Dallas, premtoi se, nëse republikanët fitojnë zgjedhjet e mesmandatit dhe mbajnë kontrollin e Kongresit, çdo i rritur amerikan do të marrë 5 mijë dollarë.

Pesë mijë dollarë nuk janë pak. Janë aq sa për ta bërë një amerikan të harrojë për disa minuta inflacionin, deficitin, borxhin publik dhe të gjitha ato gjëra që ekonomistët i përmendin zakonisht kur politikanët fillojnë të shpërndajnë para.

Trump i ka vënë edhe emër: “Trump Dividend”. Emri është shumë i rëndësishëm. Kur thua “1.2 trilionë dollarë shpenzime të reja federale”, njerëzit shqetësohen. Kur thua “Trump Dividend”, njerëzit fillojnë të mendojnë se ku do t'i shpenzojnë pesë mijë dollarët, sepse kanë bindjen se Trump nuk do t'i marrë ato para nga taksat e tyre, por do t'i marrë nga llogaria e vet personale dhe do t'ia japë popullit.

Amerika, për fat të keq, nuk ka 1.2 trilionë dollarë të tepërt në kasafortë. Përkundrazi, borxhi federal ka kaluar 40 trilionë dollarë. Por kjo është një hollësi ekonomike, por këto dalin gjithmonë pasi mbarojnë mitingjet.

Në një familje normale, po të kesh borxhe deri në grykë dhe t'u thuash fëmijëve se do t'u japësh nga pesë mijë dollarë, ata mund të gëzohen. Siç mund të gëzohen edhe disa votues. Problemi i vetëm është se, kur ua ke premtuar këtë disa herë dhe nuk ua ke dhënë, atëherë fëmijët fillojnë të të quajnë gënjeshtar dhe të mos të të besojnë më. Por ne shpesh harrojmë se në fushata elektorale e gjitha kjo quhet politikë. Dhe politika e sotme po kthehet më shumë si një ankand.

Dhe Donald Trump sapo ngriti tabelën: Pesë mijë!

Pastaj nga Michigan doli shqiptari John Goci nga Michigani, që kandidon për një vend në Dhomën e Përfaqësuesve. Ky, megjithëse nuk është fare në fletën e votimit, vazhdon fushatën “write-in”, që do të thotë se njerëzit duhet të shkruajnë emrin e tij në fletën e votimit në vend që të votojnë për kandidatët zyrtarë.

Nuk e dimë sa seriozisht e ka Goci propozimin e tij. Ndoshta e ka shumë seriozisht. Ndoshta ka bërë llogaritë. Ndoshta ka një plan që ne ende nuk e njohim. Por përshtypja e parë është se Goci ka parë pesë mijë dollarët e Trumpit dhe ka vendosur ta çojë idenë deri aty ku të çon logjika e një ankandi elektorale: Dhjetë mijë!

Në posterin e tij shkruhet qartë: Nëse John Goci fiton, do të propozojë dhe Kongresi do ta votojë që të jepen 10,000 dollarë për çdo të rritur amerikan. Dhe, me dashje apo pa dashje, Goci ka hyre në garen e premtimeve me presidentin amerikan. Dhe nga çasti kur hyn në këtë rrugë, problemi nuk është më se sa mund të paguajë Amerika. Zotesia tregohet se kush guxon të premtojë më shumë.

Po pse dhjetë mijë? Njëzet mijë janë, pa dyshim, më mirë se dhjetë mijë. Pesëdhjetë mijë janë edhe më mirë se njëzet mijë. Njëqind mijë do të ishin fantastike. Dhe aq më tepër që paratë nuk i ke nga të shtëpisë sate dhe që nuk janë as në bankë.

Nga këndvështrimi i personit që merr paratë, ky është një premtim i jashtëzakonshëm.

Vështirësitë fillojnë vetëm për personin që duhet t'i paguajë.

Prandaj, pas Gocit, pres me interes kandidatin tjetër. Ai mund të dalë nesër dhe të thotë: Unë jap 20 mijë dollarë për çdo amerikan.

Pastaj mund të vijë tjetri me 30 mijë. Një tjetër me 50 mijë. Dhe, nëse fushata zgjat edhe pak, mund të mbërrijmë në ditën e zgjedhjeve me një popull prej milionerësh, të paktën në posterat elektorale.

Askush nuk ka nevojë t'i ketë paratë në atëpërt t'i përmuad.

Në një ankand të zakonshëm, kur thua “dhjetë mijë!”, duhet t'i kesh dhjetë mijë dollarët. Në ankandin politik lejohet çdo gjë. Ti thua “dhjetë mijë!”, votuesi gëzohet, Kongresi duhet ta miratojë dhe Thesari duhet të gjejë paratë. Dhe, nëse nuk i gjen, punë e madhe. Votat që kishin rëndësi i ke marrë.

Borxhi amerikan, mbi 40 trilionë dollarë, nuk flet në mitingje. Nuk mban pankarta. Nuk kandidon. Nuk ankohet. Vetëm rritet.

Ndoshta prandaj askush nuk shqetësohet shumë për të.

Pesë mijë dollarët e Trumpit, përkundrazi, mund t'i imagjinosh menjëherë në llogarinë bankare.

Dyzet trilionët janë tepër të mëdhenj për t'i imagjinuar. Dhe njerëzit, përgjithësisht, shqetësohen më shumë për pesë mijë dollarët që mund të marrin sesa për 40 trilionët që ua kanë borxh.

Kështu politika amerikane ka hyrë, me sa duket, në një fazë të re. Dikur kandidatët konkurronin se kush do të ulte taksat, kush do të shkurtojte deficitin, kush do të krijonte më shumë vende pune. Tani është më e thjeshtë: premtojmë para cash!

Dhe, nëse dikush pyet se kush do t'i paguajë, përgjigjja mund të jepet pas zgjedhjeve. Ky është avantazhi i madh i ankandit elektoral ndaj ankandit të zakonshëm. Por një pyetje nuk po i jepnin përgjigje disa amerikanë që po diskutonin me zjarr në një McDonald's, me nga një hamburger përpara: Nëse këto para janë diku dhe popullit amerikan i duhen dhe i meriton t'i marrë shpërblim, pse të mos ia japin edhe nëse i humbet zgjedhjet?

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:25 Blog / 2 komente

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog / 1 koment

[Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK](#)

19:26 Blog / 8 komente

[Mbrojini fëmijët nga shkolla](#)

18:00 Blog / 5 komente

[A ka OSBE/ODIHR në Amerikë?](#)

17:40 Blog / 18 komente

[Shteti i Ieshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve](#)

13:50 Blog / 16 komente

[Ministrja që Rama po kërkon](#)

12:40 Blog / 15 komente

[Demokracia, jo më si vlerë lirie](#)

12:30 Blog / 7 komente

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 21 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?](#)

10:40 Kronika / 74 komente

[Genti Tare: SPAK bëri show me Igli Taren, e mbajti 6 orë ...](#)

10:50 Politika / 52 komente

[PISA, hakmarrja europiane për mësueso-fobët shqiptarë](#)

16:18 Politika / 41 komente

[Audiodërgjimi i Ahmetajt dhe akuzat për trafik armësh, qe...](#)

11:15 Politika / 74 komente

[Nga ndërhyrja te Trump, te Samiti i NATO-s! Thaçi për Ram...](#)

11:30 Politika / 36 komente

Blog Tema

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:25 Blog / 2 komente

[Haga, midis maktheve dhe paranojave](#)

21:00 Blog / 1 koment

[Parku i Liqenit me syte nga qielli dhe SPAK](#)

19:26 Blog / 8 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)
- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by